

## STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI

### Limonaj Auto Parts SHPK

Sot me date 27/03/2023, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";

- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"

**Z. Fatos Limanaqi** lindur me **07.06.01970** ne Fushe Kruje (qytet) Kruje , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,

**Z. Xhemal Limanaqi** , i lindur me **01.08.1993** ne Fushe Kruje ,Kruje madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Themelojne ne cilesine e Ortakeve te Shoqerise, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar - **Limonaj Auto Parts SHPK** me permbajtjen si me poshte vijon:

#### **KAPITULLI I**

#### **FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI**

##### **Neni 1: Forma Juridike**

Shoqeria **Limonaj Auto Parts SHPK** , eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

##### **Neni 2: Kohezgjatja**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të pezulloje ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

##### **Neni 3: Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Rruga nacionale Fushe-Kruje ,Vore ,kilometri i 7 ,Kruje .**

Gjate ushtrimit aktivitetit te saj, shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi si brenda

dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

#### **Neni 4: Objekti**

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

- a) Import automjtesh per shitje si pjese kembimi
- b) Import eksport pjese kembimi per automjete ,makineri e paisje..
- c) Sherbime, riparime, lyerje automjetesh te llojeve te ndryshme.

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjetër te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

## **KAPITULLI II** **KAPITALI**

### **Neni 5 : Kapitali themeltar**

.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 lek i formuar ne mase te plote nga kontributiet e ortakeve dhe i ndare ne dy kuota me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesieve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e secilit si me poshte:

Ortakët :

Z. Fatos Limanaqi , zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete)leke, qe perben 50% pjesmarrje te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Xhemali Limanaqi , zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete)leke, qe perben 50% pjesmarrje te kapitalit themeltar te shoqerise

## **KAPITULLI III** **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 6**

**Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:**

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

### **Neni 7**

## Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve Te drejtat dhe detyrimet

7.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji

7.3. Nese shoqeria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne një regjister te vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

## Neni 8

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve

8.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve te shoqerise. Njoftimi me shkresë duhet te permbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë perpara datës së parashikuar per mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 9

#### Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 10

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### Neni 11

#### Administrimi

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortake të saj. Afati i emërimit të administratorit është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

11.2. Administrator i pare i shoqërisë është **Z. Xhemali Limanaqi**, i cili zgjidhet për një **perjudhe 5 vjecare**.

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## Neni 12

### Kompetencat e administratoreve

Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

## Neni 13

### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridiksionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

## Neni 14

### Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

## Neni 15

### Dispozita perfundimtare


Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.


Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga ai pa asnje verejtje.

## **ORTAKET THEMELUES**

**Fatos Limanaqi**

**Xhemal Limanaqi**

  
Fatos Limanaqi

  
Xhemal Limanaqi